



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
KOMISIONI INSTITUCIONAL ZGJEDHOR

Nr. 152 Prot.

Tiranë, më 25/02/2021

VENDIM
Nr. 35, datë 25.02.2021

**PËR NDRYSHIMIN E PJESSHËM TË VENDIMIT NR. 29 TË KOMISIONIT
INSTITUCIONAL ZGJEDHUR, UMT, "PËR SHPALLJEN FITUES TË ANËTARËVE
TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË MJEKËSISË, TIRANË"**

Bazuar në ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", në nenet 6, 37 dhe 38 të Rregullores së Zgjedhjeve, miratuar nga Senati Akademik i UMT-së me Vendimin nr. 13, datë 12.02.2020 "Për miratimin e Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese dhe komisionet e përhershme në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë", në Vendimin e KIZ nr. 29, datë 01.08.2020, "Për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për anëtarë të Senatit Akademik të Universiteti të Mjekësisë, Tiranë", në Vendimin Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me nr. 3215, datë 04.12.2020, në nenet 510, 511 e vijues të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, dhe në kërkesën e kreditorit Z. Kristi Trako, KIZ në mbledhjen e datës 25.02.2021,

VENDOSI:

1. Të ndryshojë pjesërisht Vendimin nr. 29, datë 01.08.2020, "Për shpalljen e rezultatit të zgjedhjeve për anëtarë të Senatit Akademik të Universiteti të Mjekësisë, Tiranë", përkatësisht pikën 2 të tij që lidhet me tabelën nr. 2, bashkëlidhur këtij vendimi, "Lista e anëtarëve të Senatit Akademik, kategoria student". Në zbatim të Vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë me nr. 3215, datë 04.12.2020, emri i znj. **Fribianka Hoxha** të zëvendësohet me z. **Kristi Trako**, përfaqësues i studentëve në Senatin Akademik të UMT-së.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në mjediset e UMT-së, në faqen zyrtare të institucionit dhe një kopje e tij i dërgohet: Senatit Akademik të Universiteti të Mjekësisë, Tiranë, z. Kristi Trako dhe znj. Fribianka Hoxha.

**KRYETARI
SILVANA BALA**

